



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

**PLANI I VEPRIMIT PER
ZBATIMIN E STRATEGJISE
KOMBETARE TE
DIASPORES**

BULETIN

Nr. 2 Qershor 2021

AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS



PËRMBAJTJA

HYRJE	3
QËLLIMI I BULETINIT	4
ZBATIMI I MASAVE 2021 - 2025	5

Hyrje

Diaspora shqiptare ka dhënë ndër vite një kontribut të çmuar për zhvillimin ekonomik e shoqëror në atdhe. Duke u bazuar në kontributin dhe potencialet e diasporës shqiptare, institucionet shtetërore vijnë me zhvillimin dhe zbatimin e politikave shtetërore gjithëpërfshirëse për marrëdhëniet e shtetit shqiptar me diasporën.

Strategjia Kombëtare e Diasporës (2021-2025) dhe Plani i Veprimit, miratuar me Vendimin Nr.585/2020, të Këshillit të Ministrave, është një ndër dokumentet thelbësore mbi politikat e reja për diasporën. Ky dokument është vazhdim i veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024 e cila e ka përmbyllur ciklin e saj në 31 dhjetor 2021. Strategjia konsiderohet si një hap i rëndësishëm i reformës shtetërore për diasporën dhe synon të ndërtojë një bashkëpunim gjithëpërfshirës me komunitetet e diasporës. Objektivat e Strategjisë realizohen nëpërmjet zbatimit të 72 (shtatëdhjetë e dy) masave të Planit të Veprimit.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit.

Buletini Nr.2 (qershor 2021) është buletini i cili jep një informacion i detajuar mbi ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 nga institucionet shtetërore përgjegjëse për politikat e Diasporës. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave shtetërore për diasporën. Gjithashtu, publikimi i buletinit informon anëtarët e strukturave vendimmarrëse lidhur me politikat ekzistuese, sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë reformës shtetërore për diasporën.

Buletini mbetet një dokument i hapur për çdo vërejtje dhe sugjerim. Institucionet, grupet e interesit, publiku, media dhe qytetarët janë të mirëpritur për propozimet e tyre, të cilat do të shërbejnë për fuqizimin e bashkëpunimit me diasporën.

Agjencia Kombëtare e Diasporës
Tiranë
Qershor 2021

BULETINI Nr.2, Qershor 2021

QËLLIMI I PUBLIKIMIT TË BULETINIT “PËR ZBATIMIN E MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS 2021 - 2025” ËSHTË INFORMIMI I:

1. ANËTARËVE TË KOMITETIT SHTETËROR TË DIASPORËS MBI ECURINË E PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS (2021-2025), MIRATUAR ME VENDIMIN NR.585/2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE.
2. ANËTARËVE TË NËNKOMISIONIT PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË POLITIKËS SË JASHTME TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, NGRITUR ME VENDIMIN NR.98/2017, TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË.
3. INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E MASAVE TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS.
4. PUBLIKUT TË INTERESUAR PËR ECURINË E REFORMËS NË FUSHËN E MARRËDHËNIEVE ME DIASPORËN SHQIPTARE.

MASAT E PLANIT TE VEPRIMIT 2021-2025

Masa Nr. 1

Koordinimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse që legjislacioni i ri ngarkon për fushën e marrëdhënieve shtetërore me diasporën me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendrën e Botimeve për Diasporën dhe Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Hartimi i një plani të detajuar për financimin e politikave dhe masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare. Krijimi i një njësie të specializuar për rivlerësimin e legjislacionit për diasporën për të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme.

INDIKATORËT : Forcimi financiar dhe me personel i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministri i Financave dhe Ekonomisë

Janar-Mars 2021:

- U miratua Ligji Nr. 35/2021 “Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” datë 16.3.2021. Ndryshimet ligjore synojnë të rregullojnë elementë proceduralë të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe të unifikojnë kuadrin rregullator ligjor në përputhje me zhvillimet gjatë këtyre viteve të funksionimit të saj.
- U miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.430 datë 30.06.2021 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme, kritereve dhe procedurave specifike për marrjen me qira të ambienteve dhe lidhjen e kontratave të veçanta me bashkëpunëtorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë, të cilat nevojiten të kryhen me qëllim zbatimin dhe realizimin e programit vjetor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe që nuk rregullohen nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.” Akti nënligjor përcakton rregullat dhe procedurat specifike për aktivitetet e natyrës së veçantë dhe specifike që mbulon fusha e veprimtarisë së AKD-së.
- Në zbatim të Strategjisë Kombëtare e Diasporës (2021-2025) dhe Planit të Veprimit, miratuar me Vendimin Nr.585/2020 të Këshillit të Ministrave, me qëllim asistimin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e saj, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ka kontraktuar 6 (gjashtë ekspertë) të profileve të ndryshme pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bankës së Shqipërisë dhe Institutit të Statistikave. Ekspertët do të japin kontributin e tyre në mbështetjen e këtyre institucioneve për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
- Në zbatim të programit “Angazhimi i Diasporës në zhvillimin ekonomik dhe social të

Shqipërisë”, me ndihmën e zyrës së IOM në Tiranë, janë përzgjedhur 20 (njëzetë) ekspertë, të cilët jetojnë në vende të ndryshme jashtë Shqipërisë dhe i përkasin diasporës shqiptare. Këta ekspertë do të ndihmojnë administratën shqiptare në procesin e negocimit të integritit evropian të Shqipërisë.

- Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën Nr.1014 Prot, datë 23.02.2021 “Kërkesë për përfshirjen në Grupin Ndërinstitucional të Punës për kapitujt e negociatave” drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Kryenegociatorit Kombëtar IPA ka propozuar përfshirjen në Grupin Ndërinstitucional të Punës, të Agjencisë Kombëtare të Diasporës duke ju referuar fushës së kompetencave dhe veprimtarisë së ushtruar për kapitujt të Acquis të Bashkimit Evropian: 25-Shkenca Kërkim Shkencor; 26- Arsim dhe Kulturë. Referuar kësaj kërkesë, Agjencia Kombëtare e Diasporës sipas fushës së kompetencave dhe veprimtarisë është përfshirë në datën 18.03.2021 në Grupin Ndërinstitucional të Punës në lidhje me kapitujt e Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian për Kapitullin 26 -Arsim dhe Kulturë. Pjesëmarrja në këtë grup ndërinstitucional synon të realizojë përfshirjen e diasporës dhe kontributin e saj drejt integritit të Shqipërisë, si pjesë e Bashkimit Evropian.

Prill-Oershor 2021:

- Për krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, nga institucionet shtetërore të Diasporës, janë zhvilluar aktivitete të përvitshme. Ndër këto aktivitete në këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:
- Në datën 7 Qershor 2021 u zhvillua aktiviteti vjetor “Takimi i Juristëve në Diasporë”. Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Drejtësisë zhvilloi aktivitetin në mënyrë të alternuar fizikisht dhe online “Takimi i Juristëve në Diasporë”. Diskutimi u zhvillua në tre panele: “Vështrim i përgjithshëm”, “Juristët në diasporë dhe roli i tyre në sistemin e drejtësisë” dhe “Rrjetëzimi dhe ndërveprimi i profesionistëve në diasporë”.
- Në datën 16 Qershor 2021 u zhvillua aktiviteti “Dita Ndërkombëtare e Remitancave”. Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Bankës së Shqipërisë, zhvilloi aktivitetin “Dita Ndërkombëtare e Remitancave”, duke vlerësuar rolin e remitancave në ekonominë e vendit si dhe formalizimin e kanaleve të dërgimit të tyre në atdhe, objektiva kryesorë edhe të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.
- Në datën 22 qershor 2021 u zhvillua aktiviteti vjetor “Takimi i Mësuesve të Diasporës”. Takimi i Mësuesve të Diasporës 22 qershor 2021. Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë organizoi më 22 qershor 2021 “Takimin e Mësuesve të Diasporës”. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve të përfshira në procesin e mësimin në Diasporë në Republikën e Kosovës, znj. Arbërie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës si dhe znj. Liza Gashi, Zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë, të cilat diskutuan lidhur me sfidat dhe problematikat që hasin mësuesit jashtë vendit.Ky u organizua në 3 panele: Në panelin e parë u prezantua puna e realizuar nga dy Qeveritë e Shqipërisë dhe e Kosovës, për pajtimin, për regjistrimin e përbashkët të mësuesve në diasporë, për ratifikimin dhe vijimësinë e marrëveshjeve të hartuara, për organizimet e

përbashkëta të aktiviteteve dhe seminareve, për mundësimin e trajnimeve për mësuesit në diasporë, për nxitjen e marrëveshjeve me vendet pritëse për mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe aty ku jetojnë shqiptarët, etj. Në panelin e dytë u diskutua çështja e organizimit të mësimeve në diasporë dhe në panelin e tretë mësuesit shkëmbyen përvojën e tyre në mësime në diasporë.

NË PROCES

Masa Nr.4

Vlerësimi i përfaqësuesve të strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën. Ky proces do të kryejë organizimin e politikave shtetërore ekzistuese apo që do të miratohen në të ardhmen në marrëdhënie me politikat për komunitet shqiptar jashtë vendit.

INDIKATORËT : Realizimi i një takimi vjetor në nivelin teknik për përfaqësimin e Strategjisë Kombëtare të diasporës me strategjitë e tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Janar-Mars 2021:

- Është në proces të konsultimit publik Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027, referuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në të cilën vlerësohet potenciali i njohurive dhe burimeve të diasporës për zhvillimin e mëtejshëm të ekosistemit të startup-eve dhe inovacionit. Nëpërmjet masave të parashikuara në Planin e Veprimit dhe granteve përkatëse nga Buxheti i Shtetit ose donatorët do të synohet tërheqja e investitorëve të huaj dhe investitorëve të diasporës në vendin tonë.
- Është miratuar me Vendim Nr.400, datë 19.06.2019 të Këshillit të Ministrave Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019-2022. Strategjia ka për qëllim të ofrojë përgjigje gjithëpërfshirëse dhe të plota ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit në kontekstin e Shqipërisë. Ky dokument synon të sigurojë një kornizë unifikuese të parimeve të përbashkëta dhe angazhimeve ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë, duke përfshirë dimensionet humanitare, të zhvillimit dhe të drejtave të njeriut, si dhe duke përmirësuar bashkëpunimin dhe koordinimin institucional për migracionin.
- Është draftuar me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) në Shqipëri, Strategjia e Komunikimit dhe Planit të Veprimit 2021-2025, në kuadër të projektit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të

Shqipërisë”. Kjo Strategji synon të mbështesë përpjekjet e përbashkëta të Ministrit të Shtetit për Diasporën, institucionet e lidhura me angazhimin e Diasporës, shoqatat e Diasporës dhe përfaqësuesit e tyre, me qëllim integrimin e Diasporës shqiptare në jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike të Shqipërisë.

- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës dhe studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për gjuhën, historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh.
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Muzeut Historik Kombëtar, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës dhe studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh dhe publikimin e tyre.

Prill-Qershor 2021:

- Është miratuar Urdhri nr. 35, datë 10.03.2021 i Kryeministrit “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Drejtues për Migracionin me qëllim zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe të Planit të Veprimit 2019-2022”. Anëtar i këtij Grupi Drejtues është dhe Ministri i Shtetit për Diasporën. Ky Grup ka funksion mbikëqyrjen e progresit të përgjithshëm në arritjen e objektivave të politikave strategjike të migracionit dhe përmirësimin e mekanizmave të bashkërendimit.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcjellë shkresën nr. 6563 Prot., datë 12.04.2021 “Kërkesë për raportim” drejtuar Ministrit të Shtetit për Diasporën ku kërkon informacion për nivelin e zbatimit të Masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019-2022. Ministri i Shtetit për Diasporën me shkresën nr. 1924/1 Prot., datë 11.05.2021 informon mbi zbatimin e Masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019-2022.
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Kjo marrëveshje synon bashkëpunimin e ndërsjellë institucional me qëllim:
 - Hartimin, seleksionimin, përshtatjen, përmirësimin e teksteve shkollore dhe literaturës plotësuese për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë;
 - Ofrimin e përvojës për didaktikën e mësimdhënies së gjuhës shqipe jashtë vendit si dhe përgatitjen e materialeve didaktike të mësimdhënies në shërbim të një platforme digjitale të mësimin të gjuhës shqipe;
 - Organizimin e aktiviteteve dhe konferencave të përbashkëta shkencore për trajnimin e mësuesve në diasporë;
 - Krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta
- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Kjo marrëveshje synon bashkëpunimin e ndërsjellë institucional me qëllim:
 - Hartimin, seleksionimin, përshtatjen, përmirësimin e teksteve shkollore dhe

literaturës plotësuese për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë në kuadër të programit të botimeve dygjuhëshe;

- Ofrimin e përvojës për përgatitjen e botimeve dygjuhëshe si dhe përgatitjen e materialeve didaktike të mësimdhënies në shërbim të një platforme digjitale të mësimin të gjuhës shqipe, si gjuhë e dytë;
- Organizimin e aktiviteteve dhe konferencave të përbashkëta shkencore për trajnimin e mësuesve në diasporë;
- Krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta në thirrjet e projekteve të publikuara nga donatorë të ndryshëm etj.

- Në datë 16.04.2021, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është nxitja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës, studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh, për lidhjet kulturore dhe historike ndërmjet komunitetit arbëresh dhe arealit kulturor të Veriut pasi të parët që i kushtuan vëmendje gjuhës dhe letërsisë arbëreshe, ishin autorë të arealit kulturor të Veriut;
- Në datë 15.06.2021 është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi për sigurimin e kushteve të përshtatshme dhe të mundshme për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në fushën e shkencës, kulturës dhe promovimit të përbashkët të aktiviteteve.
- Në datë 15.06.2021 është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve, Shkup. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës, studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh, për lidhjet kulturore dhe historike ndërmjet komunitetit arbëresh të Italisë së Jugut dhe Arbëreshëve të Zarës në Kroaci.
- Në datë 15.06.2021 është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Universitetit “Nënë Tereza”, Shkup. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës, studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh, për lidhjet kulturore dhe historike ndërmjet komunitetit arbëresh të Italisë së Jugut dhe Arbëreshëve të Zarës në Kroaci.

NË PROCES

| Masa Nr.8 |

Vendosja e koordinimit mbi bazën e një programi të miratuar të projekteve me donatorët ndërkombëtarë për realizimin e masave të Planit të Veprimit apo që mbulojnë interesat e diasporës shqiptare.

INDIKATORËT : Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse në aplikimin për projekte kushtuar diasporës me donatorët kombëtarë dhe ndërkombëtare.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Shtetit për Diasporën

Janar-Mars 2021:

- Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Zyrës së Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në Tiranë “Për konsultim në çështjet me interes të përbashkët”. Marrëveshja parashikon konsultimin dhe bashkëveprimin për çështjet me interes të përbashkët dhe zhvillimin e aktiviteteve edhe në lidhje me zbatimin e Programit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë”.
- Është në proces zbatimi i Projektit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë”, i cili financohet nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS) dhe zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM). Projekti ka si qëllim të forcojë angazhimin dhe rritjen e kontributit të komuniteteve shqiptare jashtë vendit për zhvillimin e shtetit shqiptar përmes transferimit të dijeve dhe aftësive ekonomike.
- Në zbatim të Projektit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë”, i cili financohet nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS) është Programi “Connect Albania” (CA). Programi është një projekt inovator për rritjen e investimeve me ndërmjetësimin e diasporës. Prezantimi i Programit “Connect Albania” po implementohet fillimisht në Republikën e Italisë për të vazhduar më pas edhe me shtete të tjera. Në funksion të implementimit të këtij programi, janë zhvilluar tre takime online, me qëllimin për të krijuar një mekanizëm që t’i shërbejë forcimit të lidhjeve të Diasporës për të nxitur investimet e huaja në Shqipëri. Ky proces do të fillojë duke inkurajuar angazhimin në rritjen e investimeve nga kompanitë italiane në Shqipëri. *Takimet on-line janë zhvilluar në datat 15 Janar, 5 shkurt dhe 12 mars 2021.* Ato janë realizuar me pjesëmarrjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën; Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësues nga Zyra IOM në Shqipëri; përfaqësues të tjerë nga institucionet e Diasporës; përfaqësues nga Programi në Agjencinë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim në Tiranë, Zyra e Connect Albania si dhe përfaqësues të interesuar nga shoqëria civile.
- Në datë 08.03.2021, në kuadër të programit “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” janë prezantuar 35 (tridhjetë e pesë) ekspertë që jetojnë në vende të ndryshme jashtë Shqipërisë si pjesë e diasporës shqiptare, të cilët do të angazhohen në prioritetet negociuese të integritit evropian dhe vlerësimeve sektoriale të Shqipërisë. Ky Projekt zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, IOM Albania në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe ministri të tjera të linjës, dhe në koordinim me Ambasadën e Republikës së Italisë në Tiranë dhe Agjencinë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor.

- Më datë 21.01.2021 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit midis GIZ Albania dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për përmirësimin e “Rrjetit të Profesionistëve” dhe zhvillimin e mirëmbajtjes së moduleve të reja të këtij rrjeti. “Rrjeti i profesionistëve të Diasporës” është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet e profesioneve të ndryshme në diasporë. Qëllimi i Platformës është të mbledhë dhe të shkëmbejë informacione dhe përfshirjen e ekspertizës së anëtarëve të këtyre komuniteteve shqiptare në diasporë dhe t’i lidhë ato edhe me kërkesat e biznesit shqiptar apo të huaj me focus zhvillimin e vendit. Ai synon në një fazë të dytë të shërbejë në gjenerimin e ideve dhe nismave nga komunitetet profesionale të diasporës shqiptare. Ky rrjet është një platformë ku profesionistët shqiptarë komunikojnë në nivel profesional me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave.
- Në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve Italianë (ACI), Dhoma e Biznesit të Diasporës po zbaton Projektin “Angazhimi i diasporës në transferimin e njohurive bujqësore në Shqipëri”. Ky projekt synon përfshirjen konkrete të diasporës shqiptare në Itali në promovimin e shërbimeve dhe produkteve bujqësore në Shqipëri, rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimin e njohurive, teknikave dhe praktikave moderne të testuara, përdorimin e instrumenteve të miratuara nga Bashkimi Evropian në mbrojtje të biodiversitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në bujqësi brenda kuadrit të Marrëveshjes së Gjelbër. Me anë të këtij projekti Dhoma e Biznesit të Diasporës do të nxisë transferimin e njohurive në bujqësi nga diaspora shqiptare, (kryesisht ajo në Itali), drejt sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme bujqësore në Shqipëri në zonat rurale të Kavajës, Durrësit dhe Përmetit. Kontrata është nënshkruar në datën 01.03.2021 me Dhomën e Biznesit për Diasporën.
- Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare filloi zbatimin e Projektit “Rrënjët e mia-Kulturë 360”, i cili është bashkëfinancim i Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë. Ky projekt synon të promovojë trashëgiminë kulturore shqiptare nëpërmjet dimensioneve të reja të komunikimit dhe prezantimit që ofron teknologjia e informacionit. Aktivitetet e Projektit kanë si qëllim të minimizojnë distancat e krijuara në kushtet e pandemisë Covid-19, të gjallërojë krijimtarinë artistike, kryesisht atë tradicionale, të krijojnë një mjedis promovues dhe bashkëpunimi aktiv midis bizneseve të artizanatit vendas dhe atyre në diasporë, të evidentojnë fuqinë e artizanatit shqiptar për të sfiduar kohën dhe ruajtur origjinalitetin pavarësisht rrethanave si edhe të nxisin përfshirjen e brezave të rinj në kultivimin dhe ruajtjen e vlerave tradicionale të origjinës së tyre përtej kufijve gjeografikë.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka aplikuar për projektin me titull “Abroad but Boosting my Albanian - ABBA” në programin “Ongoing Funding Opportunity Program” në Ambasadën Amerikane. Projektin me titull “Abroad but Boosting my Albanian - ABBA” synon të zgjidhë dy probleme, të cilat lidhen me mësimdhënien në diasporë:
 - Së pari, mungesën e aftësive digjitale të mësuesve për të vepruar në përputhje me kërkesat e mësimdhënies online dhe në përputhje me masat paraprake të diktuar nga pandemia Covid-19.
 - Së dyti projekti synon të zgjidhë rritjen e numrit të ulët të regjistrimit në shkollat shqiptare të gjuhës në diasporë (5% e fëmijëve shqiptarë), duke shmangur kështu rrezikun e asimilimit të brezit të dytë e të tretë të shqiptarëve jashtë vendit.

Prill-Qershor 2021:

- Me shkresën nr. 737 Prot., datë 08.02.2021 “Kërkesë për informacion mbi projektet me financim të huaj” në kuadër të programit efektiv dhe strategjik të asistencës së huaj në Shqipëri, Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon bashkëpunimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën për përditësimin e të dhënave për projektet me financim të huaj. Ministri i Shtetit për Diasporën ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 737/1 Prot., datë 01.03.2021 “Dhënie informacioni mbi projektet me financim të huaj” drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ministri i Shtetit për Diasporës, sipas shkresës informon bashkëpunimet e huaja si më poshtë:
 - Projekti “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë”. Projekti financohet nga Bashkëpunimi Italian me përfshirjen operacionale Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS) dhe zbatohet nga zyra në Tiranë e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Ky projekt ka si qëllim të kontribuojë për të forcuar angazhimin dhe rritjen e komuniteteve shqiptare jashtë vendit për zhvillimin e shtetit shqiptar përmes transferimin atje të dijeve dhe aftësive ekonomike.
 - Projekti i “Gazeta e Diasporës Shqiptare”. Është bashkëpunim i Ambasadës së Konfederatës Zviceriane dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Ky projekt ka për qëllim informimin dhe krijimin e lidhjeve të informacionit midis komuniteteve shqiptare në Diasporë dhe Shqipërisë.
 - Projekti “Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”. Platforma Rrjeti i profesionistëve në Diasporë vjen si produkt i projektit Diaspora për Zhvillim. Platforma është krijuar me qëllimin madhor të hartëzimit të profesionistëve shqiptarë në Diasporë. Ajo u vjen në ndihmë anëtarëve të Diasporës duke iu ofruar mundësinë për të kapërcyer barrierat gjeografike, për të lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet tyre. Platforma Rrjeti i Profesionistëve i ofron përdoruesve profesionistë shqiptarë në Diasporë mundësi informimi, mundësi bashkëpunimi, mundësi punësimi, investimi etj.
- Ministri i Shtetit për Diasporën me shkresën nr. 1720 Prot., datë 31.03.2021 ka përcjellë mbështetjen e projekt propozimit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët “Ndërtimi i bazës kërkimore funksionale në Shqipëri për gjuhët e rrezikuara”.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar përmes komunikimit elektronik në lidhje me prezantimin e Programit Connect Albania, i cili po implementohet fillimisht me Italinë. Për këtë qëllim janë mbajtur 3 takime on-line, me përfaqësues të IOM, MEPJ, MSHD, dhe përfaqësues të tjerë nga shoqëria civile, për ta bërë këtë mekanizëm t’i shërbejë forcimit të këtyre lidhjeve të Diasporës me Shqipërinë, duke inkurajuar angazhimin dhe përfshirjen e tyre për rritjen e investimeve nga kompanitë italiane në Shqipëri duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka informuar përmes komunikimit elektronik lidhur me Marrëveshjen e zbatimit me GIZ Albania për projektin “Këshillimi për Migracionin në Shqipëri”. Objektivi i këtij projekti ishte lufta kundër migracionit të

parregullt, duke ofruar informacion për rrugët e ligjshme të migracionit të punës dhe duke informuar për arsimin dhe formimin profesional, si dhe perspektivat e tregut të punës në Gjermani dhe në Shqipëri. Ky projekt ka vazhduar të zbatohet gjatë vitit 2020 dhe në fillim të vitit 2021 nga GIZ Albania është propozuar teksti i një marrëveshje të re për çështjet migratore duke vazhduar bashkëpunimin e vendosur në këtë drejtim.

- Qendra e Botimeve për Diasporën ka dakordësuar me Platformën Digjitale të mësimdhënies “SchoolMe” krijimin e një seksioni të ri, të quajtur “ Mëso Shqip”, e cila do t’i dedikohet mësimin të gjuhës shqipe në Diasporë. Seksioni “Mëso Shqip” me materialet ndihmëse për mësimdhënien në Diasporë do të jetë gati për vitin e ri shkollor 2021-2022 në muajin shtator.

NË PROCES

| Masa Nr.10 |

Krijimi dhe vijueshmëria e strukturave informuese për orientimin e qytetarëve shqiptarë jashtë vendit në përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike të cilat ofrohen nga përfaqësitë shqiptare (platforma online). Dhënia e informacionit rreth organizatave jo qeveritare të akredituara nga shteti pritës, të cilat ofrojnë asistencë dhe mbrojtje ligjore për komunitetet e huaja.

INDIKATORËT: Informim periodik i Komitetit Shtetëror të Diasporës për gjendjen e orientimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit për shërbimet nëpërmjet platformës konsullore online dhe organizim komunikimi me shoqërinë civile në shtetin pritës. Organizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Drejtësisë
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Janar-Mars 2021:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar përmes komunikimit elektronik lidhur me shërbimet e reja konsullore online që kanë të bëjnë me çështje të migracionit dhe diasporës, të cilat vijojnë si më poshtë:

- Janë shtuar zyrat konsullore për aplikime për pasaporta biometrike (PP) dhe letërnjoftime (ID) pranë Ambasadave Shqiptare në Vjenë, Austri, Paris, Francë; në Berlin, Gjermani; në Stokholm, Suedi; si dhe pranë Konsullatave në Bari për Italinë, Stamboll për Turqinë, duke e çuar në 14 (katërmëdhjetë) numrin total të zyrave të aplikimit në mbarë botën.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme përdor një sërë kanalesh komunikimi për

informimin e diasporës dhe publikun e gjerë. Drejtoria e Diplomacisë Publike dhe Diasporës përdorë faqen zyrtare të Ministrisë së Evropës dhe Punët e Jashtme. Përfaqësitë diplomatike përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme komunikimin në faqet përkatëse si edhe rrjetet sociale për informimin e publikut lidhur me shërbime konsullore si dhe regjimit të lëvizjes së njerëzve në kushtet e pandemisë.

- Është mundësuar ofrimi i shërbimeve në vendbanimet e tyre për shtetasit me aftësi të kufizuar.
- Është mundësuar implementimi i firmës digjitale, projekt i cili nisi zbatimin pas miratimit të Ligjit Nr. 22/2021, datë 22.02.2021 “Për miratimin e shtesës së kontratës për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave biometrike”. Shtimi i shërbimit të transmetimit të të dhënave të shtetasve online, përmirëson procesin e punës, shkurton ndjeshëm kohën e pajisjes me dokumente biometrikë. Është arritur që nëpërmjet sistemit shtetasit që aplikojnë për Pasaporta biometrike dhe karta ID të caktojnë vetë datën dhe orën e takimit. Në periudhën janar-maj 2021 janë realizuar gjithsej nga shërbimet konsullore jashtë vendit: Kartë ID + pasaportë: 62377, Veprime të tjera konsullore: 24108.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka shtuar një adresë të dedikuar për shërbimet konsullore online shko@mfa.gov.al, ku çdo shtetasi i kthehet përgjigje brenda ditës sipas kërkesës për të cilin është i interesuar.
- Në lidhje me marrëveshjen me Italinë për njohjen e patentave shqiptare, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, informon në mënyrë periodike në rrjetet sociale të saj dhe të Përfaqësive Diplommatike të Shërbimeve Konsullore në lidhje me çështje si:
 - Protokollet e lëvizjes gjatë pandemisë;
 - Regjimin e vizave për qytetarët shqiptarë që duan udhëtojnë në vende të ndryshme të botës me dokumente shqiptare;
 - Mundësi punësimi apo shpallje të projekteve të ndryshme.
 - Është mundësuar ofrimi i shërbimeve në vendbanimet e shtetasve me aftësi të kufizuar.

Prill-Qershor 2021:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar përmes komunikimit elektronik lidhur me përditësimin e numrit të aplikimeve të realizuara nga shërbimet konsullore jashtë vendit. Është arritur që nëpërmjet sistemit shtetasit që aplikojnë për Pasaporta biometrike dhe karta ID të caktojnë vetë datën dhe orën e takimit. Në periudhën janar - qershor 2021 janë realizuar gjithsej nga shërbimet konsullore jashtë vendit: Kartë ID + Pasaportë: 76 459, Veprime të tjera konsullore: 29908.

NË PROCES

Masa Nr.30

Organizimi i Kuvendit të Diasporës Shqiptare në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Diasporës si ngjarja më e rëndësishme e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Organizimi periodik i aktivitetit mbarëkombëtar me qëllim shqyrtimin e politikave aktuale për mobilizimin e diasporës shqiptare, ku do të vlerësohen çështjet si ruajtja e gjuhës dhe kulturës, fenomeni i ikjes së trurit dhe investimet nga diaspora në Shqipëri.

INDIKATORËT: Krijimi i Grupit të Punës për përgatitjen dhe organizimin e Kuvendit të Diasporës Shqiptare në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Diasporës. Organizimi periodik i Kuvendit të Diasporës Shqiptare.

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministra e Arsimit, Sportit dhe Rinise

Janar-Mars 2021:

- Këshilli Koordinues i Diasporës dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës, në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit, kanë ngritur një grup pune të posaçëm. Në vijim të Urdhrit Nr.39, datë 09.09.2020 të Drejtorit Ekzekutiv, të Agjencisë Kombëtare të Diasporës “Për ngritjen e Grupit të Punës për mbështetjen e Këshillit Koordinues të Diasporës, me objekt organizimin e Kuvendit të III-të të Diasporës” janë realizuar takime me qëllim koordinimin mes Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Këshillit Koordinues të Diasporës për vijimësinë e punës mbi realizimin e Kuvendit të Diasporës Shqiptare.
- Këshilli Koordinues i Diasporës (KKD) ka ndërmarrë përgjegjësinë për organizimin e takimit (Kuvendit) për vitin 2021. Kuvendi i tretë i Diasporës është një aktivitet mbarëkombetar, i cili synon shqyrtimin e politikave aktuale shtetërore për diasporën shqiptare, ku do të vlerësohen çështjet si ruajtja e gjuhës dhe kulturës dhe investimet e pritshme nga diaspora në vendlindje.
- Mbi vendim-marrjen për kohën, temën dhe organizimin e Kuvendit të Tretë të Diasporës Shqiptare janë organizuar konsultime me shoqata dhe grupe të interesuara në diasporën shqiptare, si dhe është shpërndarë dhe plotësuar një pyetësor, duke përfshirë ide të reja nga anëtarë të komuniteteve shqiptare jashtë vendit për organizimin e Kuvendit.

Prill-Qershor 2021:

- Për zbatimin e Masës 30 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën prill-qershor 2021.

NË PROCES

| Masa Nr.33 |

Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme të diasporës në Shqipëri dhe dhënia e titullit “Ambasador i Kombit”. Krijimi i rrjetit të Ambasadorëve të Kombit.

INDIKATORËT: Promovimi i personaliteteve dhe krijimi i rrjetit të Ambasadorëve.

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë i 2021 (periodike deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

Janar-Mars 2021:

- Për zbatimin e Masës 33 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën janar-mars 2021.

Prill-Qershor 2021:

- Për zbatimin e Masës 33 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën prill-qershor 2021.

NË PROCES

Masa Nr.34

Përgatitja e Certifikatës së Diasporës, e cila mund të aplikohet online dhe krahas regjistrimit të të interesuarit e pajis atë me një dokument të printueshëm (“Jam Shqiptar”) i cili mund të vendoset në ambiente të hapura për të pohuar identitetin kombëtar shqiptar. Ajo do të jepet e veçantë për fëmijët që mbarojnë projektin e Shkollës Verore.

INDIKATORËT: Realizimi i projektit të Shkollës Verore dhe shpërndarja e Certifikatës “Jam Shqiptar”.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë i 2021

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

Janar-Mars 2021:

- Për zbatimin e Masës 34 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën janar-mars 2021.

Prill-Qershor 2021:

- Për zbatimin e Masës 34 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën prill-qershor 2021.

NË PROCES

Masa Nr.56

Krijimi i një strukture permanente e cila do të ndjekë trajnimin e mësuesve që do të japin

mësim në diasporë. Sigurimi i vazhdueshëm i teksteve shkollore për diasporë dhe trajnimi i mësimdhënësve mbi kurrikulat e përbashkëta me Kosovën. Dërgimi i mësuesve me kontratë nga Shqipëria në shtetet pritëse nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

INDIKATORËT : Forcimi i strukturës permanente (Qendrës së Botimeve në Diasporë), për tekstet shkollore dhe trajnimin e mësuesve ; Sigurimi i teksteve shkollore dhe trajnimi i mësimdhënësve. Dërgimi mësuesve me kontratë në shtetet pritëse.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**
- **Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme**

Janar-Mars 2021:

- Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, datë 23.03.2015, *“Për organizimin e përbashkët të mëimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”* është hartuar Vendimi nr. 756, datë 23.9.2020 i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, *“Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën”*, që ka përcaktuar 5 anëtarë nga Kosova dhe 5 anëtarë (4 MASR, 1 Qendra e Botimeve për Diasporën) nga Shqipëria si pjesë e Komisionit të Përbashkët.
- Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën ka hartuar dhe miratuar me Vendimin Nr.1, datë 29.01.2021: Standardet e teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën si dhe paketën e dokumenteve për procedurat e konkurimit për tekstet mësimore të përbashkëta për diasporën.
- Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën ka hartuar dhe miratuar me Vendimin Nr.2, datë 29.01.2021: Kriteret për recensuesit e teksteve mësimore për diasporën dhe shpalljen e konkursit për tekstet mësimore për diasporën.
- Është miratuar Urdhri i Përbashkët Nr. 762/1 prot., datë 9.02.2021 i Ministrit të Shtetit për Diasporën, Nr. 915/1 prot., datë 09.02.2021 e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Nr. 234 prot., datë 16.02.2021 e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës *“Për miratimin e paketës së dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, kriterëve për recensuesit e teksteve mësimore për diasporën dhe shpalljen e konkursit për tekstet mësimore për diasporën”*.
- Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, pranë QBD-së, me Vendimin nr. 1, datë 11.01.2021 miratoi propozimin e listës së anëtarëve të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve të Diasporës dërguar për miratim Ministrit të Shtetit për Diasporën.

- Qendra e Botimeve për Diasporën ka përcjellë shkresën Nr. 159 Prot, datë 12.01.2021 drejtuar Ministrit të Shtetit për Diasporën “Mbi anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimit të Diasporës e propozuar nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën” nga radhët e arsimtarëve shqiptarë në Diasporë.
- Është përditësuar regjistri shtetëror i mësuesve të diasporës. Mësuesit e diasporës, sipas kriterëve të përcaktuara me Vendimin Nr. 104/2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”, aplikuan në tetor - nëntor 2020 pranë ASCAP, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për t’u bërë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të diasporës. Në përfundim të fazës së vlerësimit të dokumentacionit të tyre u miratuan në regjistrin shtetëror të mësuesve në diasporë, 23 (njëzet e tre) mësues.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka vendosur në dispozicion në faqen e saj zyrtare online, pa pagesë, tekstin shkollor “Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare” Niveli 1/2/3. Teksti është hartuar në bazë të programit të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët shqiptarë që jetojnë jashtë kësaj Republike dhe është fitues i konkursit të shpallur po nga kjo Ministri, në vitin 2011.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka botuar dhe ka vënë në dispozicion pa pagesë librin në faqen e saj zyrtare online “Tregime të moçme shqiptare”, me autor Mitrush Kutelin, të përkthyer në pesë gjuhë: anglisht, italisht, greqisht, gjermanisht dhe frëngjisht.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar në faqen e saj zyrtare online (pa pagesë) revistën “Letra nga diaspora”, në gjuhën angleze.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme informon përmes komunikimit elektronik se është organizuar online takimi në kuadër të identitetit shqiptar, historisë dhe kulturës shqiptare në Diasporë me Ministren për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Olta Xhaçka me 20 (njëzetë) mësues në Diasporë nga vendet e Evropës, SHBA dhe Kanada, me rastin e ditës së mësuesve, “7 marsit”. Përmes këtij takimi u realizuan bashkëbisedime mbi arritjet, problematikat dhe sugjerimet për përmirësimin e punës në të ardhmen.
- Është organizuar në Prishtinë takimi me Grupin e Punës të Ministrisë së Evropës dhe Punët e Jashtme së Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Jashtme dhe Diasporës të Kosovës, bazuar në Protokollin e Bashkëpunimit të Diplomacisë Kulturore midis dy vendeve. U diskutuan detyrat dhe përgjegjësitë për aktivitetet e përbashkëta arsimore, kulturore dhe historike.

Prill-Qershor 2021:

- Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë organizoi më 22 qershor 2021 “Takimin e Mësuesve të Diasporës”. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve të përfshira në procesin e mësimit në Diasporë në Republikën e Kosovës, Znj. Arbërie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës dhe Znj. Liza Gashi, Zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë, të

cilat diskutuan lidhur me sfidat dhe problematikat që hasin mësuesit jashtë vendit. Ky takim u organizua në 3 panele: Në panelin e parë u prezantua puna e realizuar nga dy Qeveritë e Shqipërisë dhe e Kosovës, për pajtimin për regjistrimin e përbashkët të mësuesve në diasporë, për ratifikimin dhe vijimësinë e marrëveshjeve të hartuara, për organizimet e përbashkëta të aktiviteteve dhe seminareve, për mundësimin e trajnimeve për mësuesit në diasporë, për nxitjen e marrëveshjeve me vendet pritëse për mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe aty ku jetojnë shqiptarët, etj. Në panelin e dytë u diskutua çështja e organizimit të mësimit në Diasporë dhe në panelin e tretë mësuesit shkëmbyen përvojën e tyre në mësimit në Diasporë.

- Në datë 19.04.2021 është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi për zhvillimin e aktiviteteve të Përbashkëta ndërmjet Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka përcjellë shkresën nr. 142 Prot., datë 25.05.2021 Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Evropës dhe Punët e Jashtme “Informacion mbi takimin në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë”. Në këtë takim u diskutuan këto çështje:
 - Koordinimi për planifikimin, botimin dhe shpërndarjen e librave bazë, librave ndihmës dhe mjeteve të tjera mësimore për shkollat me mësimit plotësues në gjuhën shqipe në diasporë dhe në mërgatë, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në vitin 2015-2017.
 - Caktimi i dinamikës për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta, projekteve të përbashkëta dhe evidentimin e disa problemeve organizative të krijuara në ditët e fundit rreth organizimit të mësimit plotësues në diasporë.
- Qendra e Botimeve për Diasporën me shkresën nr. 158 Prot., datë 11.06.2021 informon Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ministrin e Shtetit për Diasporën, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës lidhur me takimin e zhvilluar në datë 09.06.2021 të Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve mësimore për diasporën. Në këtë takim u diskutua mbi procedurën e përzgjedhjes dhe mënyrën e pagesës së recensuesve për vlerësimin e teksteve të përbashkëta për diasporën si dhe në përfundim të diskutimeve u morën këto vendime:
 - Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën ka hartuar dhe miratuar me Vendimin Nr.3, datë 09.06.2021: Për miratimin e “Kalendarit të punës për përzgjedhjen e recensuesve”.
 - Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën ka hartuar dhe miratuar me Vendimin Nr.4, datë 09.06.2021: Për miratimin e “Thirrjes për aplikim të recensentëve”.

Ndër të tjera në mbledhjen e datës 9 qershor 2021 u vendos:

- Organizimi në parim i shpërndarjes së teksteve mësimore për diasporën. Për këtë u propozua formimi i një grupi pune ndërinstitucional me pjesëmarrës nga Drejtoria e Diplomacisë Publike dhe Diasporës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Qendra e Botimeve për Diasporën e Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës.
 - Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e marrëveshjeve ndërqeveritare me fokus mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë.
 - T’u propozohet ministrive përgjegjëse për arsimin në Shqipëri dhe në Kosovë zhvillimi fizik i përbashkët i Seminarit të 16-të Kombëtar për Mësimin Plotësues në Diasporë.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka përcjellë shkresën nr. 2385 Prot., datë 14.05.2021 drejtuar Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë” për “Mbi prodhimin e certifikatave të regjistrimit për mësuesit sipas listës së mësuesëve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë të regjistrit shtetëror përcjellë nga MASR-ja”. Në këtë shkresë Qendra e Botimeve për Diasporën informon se ka prodhur 36 certifikata për mësuesit, sipas listës së përcjellë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
 - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresën nr. 7316 Prot., datë 17.06.2021 “Përcjellja e listës së kërkesave për tekste mësimore për shkollat e mësimin plotësues në Diasporë për vitin shkollor 2021-2020” drejtuar Qendrës së Botimeve për Diasporën ku përcjell listën e kërkesave dhe nevojave të evidentuara për tekste mësimore të të tre niveleve “Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare”. Këto kërkesa janë mbledhur nga përfaqësitë diplomatike, shoqatat e mësuesve të gjuhë shqipe dhe shoqata të ndryshme të angazhuara me mësimdhënien e gjuhës shqipe në Diasporë.
 - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka përcjellë shkresën nr. 3262/2 Prot., datë 30.06.2021 “Kërkesë për pajisje me certifikatë të nxënësve të Diasporës” drejtuar Qendrës së Botimeve për Diasporën ku sipas kërkesës nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme kërkon pajisjen me certifikata për nxënësit që përfundojnë programin mësimor të gjuhës dhe kulturës shqiptare në Zvicër.

NË PROCES

| Masa Nr.65 |

Planifikimi dhe realizimi i një fushate informuese mbi :

- Çështje që kanë të bëjnë me migracionin dhe diasporën ;
- Promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës (pas miratimit);
- Identitetin e shqiptarëve, historinë dhe kulturën shqiptare në diasporë ;
- Forcimi i Gazetës “Diaspora Shqiptare” me burime informative për çështje që

interesojnë migracionin dhe diasporën dhe trajtimet rreth zhvillimeve më të fundit politike, sociale dhe ekonomike në vend. Reflektimi në këtë fushatë të procesit që diaspora dhe migracioni do të jenë pjesë integrale të zhvillimeve politike dhe ekonomike të Shqipërisë.

INDIKATORËT : Organizimi i fushatës informuese për regjistrimin e migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës ; Organizimi i një aktiviteti vjetor në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë ;

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë 2021 (periodike)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Janar-Mars 2021:

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresën Nr. 1402 Prot, datë 02.02.2021, “Kërkesë për bashkëpunim”, ka kërkuar mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, në lidhje me identifikimin e artistëve të rinj, të cilët mund të realizojnë një bust dinjitoz dhe me cilësi të lartë artistike për figurën e heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut, në kuadër të angazhimit të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bullgari, për vendosjen e bustit të Skënderbeut në Sofie.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës, me shkresën Nr. 36/1, datë 10.02.2021, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, “Kthim përgjigje”, referuar të dhënave që disponon ka propozuar emrin e një artisti shqiptar të njohur, për realizimin e veprës artistike përkatëse.
- Ministria e Brendshme është angazhuar për saktësimin e adresave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, që është bërë e mundur përkatësisht nga shërbimi i ofruar nga *e-Albania*, nëpërmjet të cilit shtetasit që jetojnë jashtë vendit deklarojnë adresën e tyre dhe ngarkojnë një dokument mbështetës së deklaratës. Kjo deklaratë procesohet nga punonjësi i zyrës së gjendjes civile përkatëse, i cili në fund përditëson adresën e shtetasit jashtë vendit. Në këtë mënyrë, të dhënat në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, saktësohen çdo ditë me deklaratimet që mbërrijnë. Deri më tani janë procesuar 1475 deklaratat, ndërkohë që po shqyrtohen 3021.
- Është ndërmarrë nisma “Dhuro Libra” për shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimin në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Greqi dhe Itali. Janë dhuruar rreth 10 mijë libra nga shtëpi të ndryshme botuese në vend, individë dhe institucione të ndryshme, të cilat janë shpërndarë në datë 21 shkurt 2021, në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës amtare. Kjo nismë u mbështet nga Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria e Drejtësisë.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka iniciuar projektligjin “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve Inovative”, një proces konsultimi, i cili do të krijojë më shumë hapësirë edhe për investitorët e diasporës që duan të krijojnë një biznes të ri inovativ në vendin tonë. Projektligji synon përcaktimin e lehtësirave fiskale, programeve dhe masave që mbështesin Startup-et Inovative në fazën fillestare të biznesit (periudha e inkubimit) dhe krijimin e një eko-sistemi të favorshëm për to në Republikën e Shqipërisë. Projektligji parashikon organet shtetërore, të cilat ngarkohen me detyrat dhe kompetencat për mbështetjen e Startup-eve Inovative; përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurat që zbatohen për miratimin, mbështetjen, vlerësimin dhe monitorimin e Startup-eve Inovative.

Prill-Qershor 2021:

Ministri i Shtetit për Diasporën ka përcjellë shkresën nr. 1341 Prot., datë 10.03.2021 “Kërkesë për përditësimin e informacionit në seksionin *Diaspora*” drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka informuar përmes komunikimit elektronik se janë realizuar këto aktivitete:

- Hapja e sesionit dedikuar Diasporës në faqen zyrtare të MEPJ; <http://punetejashtme.gov.al/diaspora-new.php>
- Publikimi i VKM-së për krijimin e regjistrit të Diasporës Shqiptare nëpër botë, në të gjitha faqet e ambasadave;
- Realizimi i disa aktiviteteve të organizuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në kuadër të promovimit të “Identiteti i shqiptarëve, historia dhe kultura shqiptare në Diasporë”, si për shembull: Është organizuar online takimi në kuadër të identitetit shqiptar, historisë dhe kulturës shqiptare në Diasporë me Ministren për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Olta Xhaçka me 20 (njëzetë) mësues në Diasporë nga vendet e Evropës, SHBA dhe Kanada, me rastin e ditës së mësuesve, “7 marsit”. Përmes këtij takimi u realizuan bashkëbisedime mbi arritjet, problematikat dhe sugjerimet për përmirësimin e punës në të ardhmen. Është organizuar në Prishtinë takimi me Grupin e Punës të Ministrisë së Evropës dhe Punët e Jashtme së Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Jashtme dhe Diasporës të Kosovës, bazuar në Protokollin e Bashkëpunimit të Diplomacisë Kulturore midis dy vendeve. U diskutuan detyrat dhe përgjegjësitë për aktivitetet e përbashkëta arsimore, kulturore dhe historike.
- Takim i Mësuesve të gjuhës shqipe në Diasporë.
- Takimi në Ditën Ndërkombëtare të Remitancave.
- Takime dhe forume të hapura të organizuara nga ambasadat shqiptare nëpër botë, si në Itali, Kanada, Australi, Turqi etj., në kuadër të promovimit të kulturës shqiptare.
- Përfundimi i fazës së parë të procesit të mbledhjes së kërkesave për tekste shkollorë në Diasporë për vitin shkollor 2021-2022.
- Takime me shoqatat shqiptare

- Për krijimin e rrjeteve të profesionistëve në komunitetet shqiptare në Diasporë, nga institucionet shtetërore të Diasporës, janë zhvilluar aktivitete të përvitshme. Ndër këto aktivitete në këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:

- Takimi i Juristëve në Diasporë 7 Qershor 2021. Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Drejtësisë

zhvilloi aktivitetin online “Takimi i Juristëve në Diasporë”. Diskutimi u zhvillua në tre panele: “Vështrim i përgjithshëm”, “Juristët në diasporë dhe roli i tyre në sistemin e drejtësisë” dhe “Rrjetëzimi dhe Ndërveprimi i Profesionistëve në diasporë”.

- Takimi “Dita ndërkombëtare e Remitancave” datë 16 Qershor 2021. Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Bankës së Shqipërisë zhvilloi aktivitetin “Dita Ndërkombëtare e Remitancave”, duke vlerësuar kështu këtë kontribut të remitancave në dobi të familjeve të vendit si dhe formalizimin e kanaleve të dërgimit të tyre në atdhe, objektiva kryesore këto dhe të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.
- Takimi i Mësuesve të Diasporës 22 qershor 2021. Qendra e Botimeve për Diasporën, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë organizoi më 22 qershor 2021 “Takimin e Mësuesve të Diasporës”. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve të përfshira në procesin e mësimin në Diasporë në Republikën e Kosovës, Znj.Arbërie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës dhe Znj.Liza Gashi, Zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë, të cilat diskutuan lidhur me sfidat dhe problematikat që hasin mësuesit jashtë vendit.Ky takim u organizua në 3 panele: Në panelin e parë u prezantua puna e realizuar nga dy Qeveritë e Shqipërisë dhe e Kosovës, për pajtimin për regjistrimin e përbashkët të mësuesve në diasporë, për ratifikimin dhe vijimësinë e marrëveshjeve të hartuara, për organizimet e përbashkëta të aktiviteteve dhe seminareve, për mundësimin e trajnimeve për mësuesit në diasporë, për nxitjen e marrëveshjeve me vendet pritëse për mbështetjen e mësimin të gjuhës shqipe aty ku jetojnë shqiptarët, etj. Në panelin e dytë u diskutua çështja e organizimit të mësimdhënies në Diasporë dhe në panelin e tretë mësuesit shkëmbyen përvojën e tyre në mësimdhënien e gjuhës shqipe në Diasporë.

NË PROCES

| Masa Nr. 66 |

Rishikimi dhe vlerësimi i zonës së transmetimit nga televizionet dhe radiot shqiptare kombëtare në të gjitha vendet ku ka komunitete të diasporës dhe migrantësh shqiptarë. Krijimi dhe nxitja e programeve televizive në vend për temën e diasporës dhe protagonizmin e saj në shoqërinë shqiptare. Forcimi i kanalit të televizionit publik TVSH 3 për temën e diasporës. Nxitja për marrëveshje me mediat në vendet pritëse, me qëllim transmetimin prej tyre të programeve për komunitetet shqiptare.

INDIKATORËT: Realizimi i një aktiviteti vjetor për programet televizive për diasporën; Projekt për forcimin e kanalit të televizionit publik për diasporën TVSH 3;

AFATI KOHOR: 6 muhori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Janar-Mars 2021 :

- Për zbatimin e Masës 66 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën janar-mars 2021.

Prill-Qershor 2021:

- Për zbatimin e Masës 66 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën prill-qershor 2021.

NË PROCES

Masa Nr.67

Krijimi i projekteve mediatike që nxisin krijimin e rrjeteve informuese për studentët dhe koordinimin e institucioneve përgjegjëse për arsimin për promovimin e rritjes së programeve të shkëmbimit dhe internship-it, të universiteteve shqiptare me universitetet në vendet pritëse me prani të lartë të studentëve shqiptarë.

INDIKATORËT : Realizimi i një aktiviteti vjetor dhe krijimi i projekteve mediatike dhe i programeve të shkëmbimit dhe internship-it.

AFATI KOHOR: 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Janar-Mars 2021:

- Për zbatimin e Masës 67 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën janar-mars 2021.

Prill-Qershor 2021:

- Në kuadër të zbatimit të vendimit Nr. 504, datë 24.6.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për Krijimin e Bazës të të Dhënave Shtetërore të Studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”, Agjencia Kombëtare e Diasporës është në proces zbatimi të këtij vendimi. Baza e të dhënave shtetërore e studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ka si institucion administrues Agjencinë Kombëtare të Diasporës.

Monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës mbi vlerësime 3 mujore (me Buletin periodik) dhe kryerja e informimit në Komitetin Shtetëror për Diasporën dhe në Nënkomisionin për Migracionin dhe Diasporën. Nënkomisioni kur e gjykon do të propozojë që për çështjen e trajtimit të migracionit dhe diasporës Kuvendi të miratojë një rezolutë për këtë çështje.

AFATI KOHOR: 6-mujori i Parë 2021 (periodike deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- Ministri i Shtetit për Diasporën
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Janar-Mars 2021:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës ka publikuar Raportin Vjetor të veprimtarisë së saj për vitin 2020.
- Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar Raportin Vjetor të veprimtarisë së saj për vitin 2020.
- Në datë 21 dhjetor 2020 u zhvillua online mbledhja me pjesëmarrës Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe Agjencitë përgjegjëse për Diasporën, të cilët raportuan në Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvend lidhur me realizimet, ecurinë e punës përgjatë vitit 2020 dhe objektivat për vitin e ardhshëm.
- Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, është zhvilluar “Takimi me koordinatoret” në datë 15 shkurt 2021, me qëllim monitorimin e masave dhe nivelin e zbatimit të tyre nga institucionet përgjegjëse shtetërore, bazuar në formatin *Masë-Indikator-Rezultat*.

Prill-Qershor 2021:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Është publikuar numri i parë (Mars 2021) i Buletinit për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave e masave shtetërore për Diasporën

Përcaktimi i indikatorëve të cilët do të evidentojnë nivelin e zbatimit të masave të

vendosura nga kjo strategji. Detyrimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë për hartimin e raporteve periodike për masat të marra duke përfshirë të dhëna sasiore edhe cilësore të monitorimit, bazuar në indikatorët e përcaktuar.

AFATI KOHOR: 6-mujori i Parë 2021 (periodik deri në 2025)

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:

- **Ministri i Shtetit për Diasporën**
- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

Janar-Mars 2021:

- Është miratuar Urdhri Nr.30, datë 17.02.2021 “Për përcaktimin e Grupit të Koordinatorëve për Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025”. Ministri i Shtetit për Diasporën me shkresën Nr. 933 Prot, datë 18.02.2021 i është drejtuar të gjitha institucioneve që janë anëtare në këtë grup pune.
- Ministria e Brendshme ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 933 Prot, datë 24.02.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 1477 Prot, datë 18.03.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Instituti i Statistikave ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 255/1 Prot, datë 23.02.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 933/3 Prot, datë 03.03.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Akademia e Shkencave ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 933/2 Prot, datë 05.03.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Ministria e Kulturës ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 944/1 Prot, datë 08.03.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 933/1 Prot, datë 26.02.2021 “Për përcaktimin e përfaqësuesit për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr.30, datë 17.02.2021”.
- Në datë 15.02.2021 është zhvilluar online nëpërmjet platformës “Webex”, takimi i koordinatorëve mbi planin e veprimit “Për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të

Diasporës”, për periudhën e 6 (gjashtë) mujorit të parë 2021.

Prill-Qershor 2021:

- Për zbatimin e Masës 72 nuk ka informacion të përditësuar për periudhën prill-qershor 2021.
- Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Është publikuar numri i parë (Mars 2021) i Buletinit për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave e masave shtetërore për Diasporën.

